REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË**

**QENDRA E PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE**

**SEKTORI I HARTIMIT TË PLANEVE TË REHABILITIMIT DHE ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE TË SPECIALIZIMIT**

Nr. 41 prot.

Tiranë, më 27.01.2023

Lënda: Plan pune për vitin 2023, Sektori i Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Zhvillimit të Programeve të Specializimit

Në vijim të ecurisë së punës të Sektorit të Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Zhvillimit të Programeve të Specializimit për vitin 2023, bashkëlidhur po ju propozojmë për miratim nga ana juaj planin e punës. Plani i punës vjetor, për këtë sektor parashikon këto objektiva të strukturuara si vijon:

| Nr. | Objektivat | Treguesi i suksesit/Qëllimi | Masa dhe veprime të planifikuara | Sektori përgjegjës/Pozicioni përgjegjës | Afati |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Ndjekja dhe mbikëqyrja e rasteve të të miturve të sapoliruar nga IM Kavajë, në bashkëpunim me institucionet kompetente. | Rehabilitimi i të miturve/të rinjve, si dhe parandalimi i recidivizmit. | • Komunikim i vazhdueshëm me NJMF-të përkatëse, Shërbimin e Provës, etj., për t'u informuar mbi gjendjen social-ekonomike të të miturve pas daljes nga institucioni i vuajtjes së dënimit, si dhe zhvillimi i takimeve me të miturit dhe familjet e tyre, për të evidentuar nevojat e tyre, si dhe për të parë vijueshmërinë e tyre, psh. a po ndjekin procesin | Sektori i Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Zhvillimit të Programeve të Specializimit (SHPRZHPS) | Janar-Dhjetor 2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | mësimor, a po ndjekin kurse/trajnime, a janë punësuar (sipas rastit), etj. | | |
| 2. | Forcimi i bashkëpunimit me pushtetin lokal/Shërbimin e Provës/IM Kavajë/ASHDMF, si dhe organizata që kanë si fushë veprimtarie mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. | Realizimi i veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese për të miturit/të rinjtë pas kryerjes së dënimit, me qëllim rehabilitimin, si dhe parandalimin e kriminalitetit/recidivizmit. | • Takim me përfaqësues të IM Kavajë, Shërbimit të Provës, ASHDMF/NJMF, me organet e vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo institucion apo OJF, me qëllim krijimin e urave të komunikimit në të mirë të procesit të punës. | SHPRZHPS<br><br>Specializimit Shërbimi i Provës<br><br>IM Kavajë<br><br>ASHDMF/NJMF<br><br>Organet e vetëqeverisjes vendore<br><br>OJF/Biznese private | Janar-Dhjetor 2023 |
| 3. | Administrimi i dokumentacionit personal të të miturit. | Mbajtja e dosjeve me informacion personal për të miturit në konflikt me ligjin, dhe mbarëvajtjen e rehabilitimit të tyre. | • Bashkëpunimi dhe komunikimi shkresor dhe elektronik me IM Kavajë, të cilët pasi na bëjnë me dije rastet e të miturve që lirohen së fundmi nga IEVP, na dërgojnë gjithashtu kopjen e dokumentacionit përkatës për çdo të mitur që referojnë | SHPRZHPS<br>IM Kavajë | Janar-Dhjetor 2023 |
| 4. | Hartimi i raportit për çdo të mitur të trajtuar pas përfundimit të periudhës 6-mujore të mbikëqyrjes. | Hartimi i raportit, i cili do të bëhet pjesë e dosjes personale të të miturit. | • Mbledhja e informacioneve përkatëse nga institucionet kompetente që ndjekin rastin, si IM Kavajë, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës apo Shërbimi i Provës. | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | • Pas shqyrtimit të të gjithë të dhënave/dokumenteve të depozituara, si dhe pas ndjekjes dhe ofrimit të shërbimeve, Sektori i Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Zhvillimit të Programeve të Specializimit harton një raport përfundimtar mbi rastin, i cili bëhet pjesë e dosjes personale të të miturit si dhe do të pasqyrohet në Sistemin e Integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur. | | |
| **5.** | Ndjekja e procesit të programimit dhe koordinimit të trajnimit dhe specializimit të profesionistëve për drejtësinë për të miturit. | Koordinimi i procesit dhe nxjerrja në pah e nevojave për trajnime të reja (nëse ka) | • Koordinimi i procesit dhe marrja e informacionit nga organet kompetente mbi vijueshmërinë e këtij procesi – tematikat e trajtuara, si dhe lista e personave të trajnuar.<br>• Komunikimi dhe bashkëpunimi me organet kompetente apo organizata të ndryshme.<br>• Propozimi i temave dhe metodikave të nevojshme për zhvillimin e specializimeve tek institucionet kompetente, në rast se shihet e nevojshme. | SHPRZHPS<br>Shërbimi i Provës<br>Shkolla e Magjistraturës<br>Prokuroria e Përgjithshme<br>Akademia e Sigurisë, etj. | Janar-Dhjetor 2023 |
| **6.** | Komunikime të vazhdueshme me IM Kavajë. | Shkëmbim informacioni në mënyrë periodike | • Komunikimi dhe përditësimi i të dhënave për të miturit që përfundojnë kryerjen e dënimit në IEVP Kavajë. | SHPRZHPS IM Kavajë | Janar-Dhjetor 2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 7. | Tryezë e Rrumbullakët me NJMF, dhe Shërbim Social në nivel vendor në të gjithë territorin e vendit. | Përmirësimi i bashkëpunimit me NJMF, për ti ardhur në ndihmë në mënyrë sa më efektive | • Evidentimin e nevojave dhe problematikave të hasura nga NJMF/PMF, dhe si mund të asistojë QPKMR në lehtësimin e tyre;<br>• QPKMR mban kontakt të vazhdueshëm me të gjitha NJMF-të në vend, dhe ka evidentuar problematika të shumta | SHPRZHPS<br>NJMF | Janar-Dhjetor 2023 |
| 8. | Krijimi i hapësirave dhe programeve reahbilituese dhe riintegruese për të rinjtë 18-21 vjeçar që kanë kryer vepër penale në kohën kur kanë qenë të mitur. | Rehabilitimi dhe riintegrimi i të rinjve (18-21 vjeç). | • Vlerësimi periodik i recedivizmit tek të rinjtë (18-21 vjeç) dhe përgatitja e një raporti me masa konkrete për parandalimin e kriminalitetit dhe uljen e recidivizimit. | SHPRZHPS<br>DPB | Janar-Dhjetor 2023 |
| 9. | Fushata ndërgjegjësuese në arsimin para universitar mbi edukimin ligjor në shkolla, në të gjithë Republikën e Shqipërisë. | Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i të miturve në arsimin para universitar | • Në bazë të një kalendari vjetor do të zhvillohen fushata ndërgjegjësuese në të gjithë territorin e vendit.<br>• Do të prezantohet manuali i përgatitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe QPKMR | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |
| 10. | Promovimi i modeleve pozitive të të miturve në konflikt me ligjin me qëllim riintegrimin e tyre. | Mbështetja e të miturve në procesin e rehabilitimit të tyre. | • Sensibilizim me shembujt e suksesit.<br>• Krijimi i një shoqërie reaktive dhe jo indiferente ndaj rasteve të tilla.<br>• Njohja me arsyet që i çojnë të miturit në krim.<br>• Trajtimi i mënyrave më produktive për rehabilitimin e tyre. | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **11.** | Informimi i të miturve dhe prindërve në lidhje me parandalimin e kryerjes/përfshirjes në vepra penale ose nga viktimizimi prej tyre. | Informim dhe edukimi i sensitivitetit publik lidhur me këto raste. | • Takime periodike në komunitet mes QPKMR, NJMF, SPZ dhe aktorëve të tjerë për të informuar fëmijët dhe prindërit në lidhje me parandalimin e kryerjes/përfshirjes në vepra penale ose nga viktimizimi prej tyre. | SHPRZHPS<br>NJMF<br>SPZ<br>etj | Janar-Dhjetor 2023 |
| **12.** | Krijimi i hapësirave të sigurta virtuale dhe mbrojtja ndaj bullizimit online të fëmijëve. | Mbrojtja e të miturve nga bullizmi, ngacmimet seksuale apo cfarë do lloj ngacmimi tjetër | • Krijimi i hapësirave të sigurta virtuale do të sigurohet nëpërmjet krijimit të një platforme online.<br>• Prezantimi i kësaj platforme në komunitet. | SHPRZHPS<br>Parter | Janar-Dhjetor 2023 |
| **13.** | Trajnimi i stafit nga ekspertë vendas dhe të huaj të drejtësisë penale për të mitur. | •Zhvillimi i metodave të punës;<br>•Rritje e kapaciteteve të stafit;<br>•Nxitja e punës në grup;<br>•Hartim/përmirësim i moduleve dhe metodave të punës. | • Trajnimeve në lidhje me zbatimit e programeve:<br>a) mbështetja e të miturit pas lirimit me kusht;<br>b) mbikëqyrja pas kryerjes së dënimit si dhe teknikat e komunikimit<br>c) etj | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |
| **14.** | Përgatitja artikujve, manualeve dhe broshurave. | Krijimi i mundësive të promovimit të drejtësisë penale për të mitur për studentët dhe publikun e interesuar | • Prezantimi i artikujve, manualeve dhe broshurave që QPKMR ka në portofolin e saj, në aktivitete të ndyshme që QPKMR organizon, në faqen web etj | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 15. | Konferencë Shkencore Kombëtare/ Ndërkombëtare lidhur me drejtësinë penale për të mitur. | Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të stafit | • Prezantimi i artikujve shkencorë nga ekspertë të fushës dhe profesionistë të drejtësisë si: Pedagog, Prokurorë, Gjyqtarë, Avokat, Studentë etj. | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |
| 16. | Fushatë sensibilizuese me bizneset, kompanitë, organizatat e punësimit për punësimin e të miturve të cilët kanë vuajtur një dënim penal. | Mbështetja e të miturve në procesin e rehabilitimit të tyre. | • Komunikim me rrjetin e bizneseve, kompanive, organizatave të punësimit për punësimin e të miturve të cilët kanë vuajtur një dënim penal.<br>• Krijimi i mundësive dhe programeve për këtë kategori të miturish. | SHPRZHPS Biznese | Janar-Dhjetor 2023 |
| 17. | Përfshirja e modulit mbi edukimin ligjor në kurrikulën shkollore. | Informim, sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i të miturve në arsimin para universitar | • Takim me Shkollën e Drejtorëve lidhur me futjen e një moduli për trajtimin e rasteve të të miturve që kanë qenë të dënuar, kur kthehen në institucionet arsimore. | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |
| 18. | Zhvillimi i Programeve të përbashkëta me Drejtorinë e Arsimit Profesional lidhur me ofrimin e kurseve profesionale | Riintegrimi I të miturve pas kryerjes së dënimit penal | • Draftimi i programeve të përbashkëta me Drejtorinë e Arsimit Profesional lidhur me ofrimin e kurseve profesionale.<br>• Implementimi i këtyre programeve | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |
| 19. | Konceptimi i Bibliotekës Digjitale pranë QPKMR, si dhe krijimi i një ambienti miqësor bashkë me një bibliotekë fizike për të zhvilluar takime, aktivitete, programe të edukimit ligjor me të mitur nga i gjithë vendi. (Dhoma e të miturve) | Lehtësimi i aksesimit nga të gjithë grup moshat. | • Grumbullimi i legjislacionit, raporteve, studimeve, artikujve, analizave mbi drejtësinë penale për të mitur. | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **20.** | Konceptimi i një spoti prezantues sensibilizues lidhur me edukimin ligjor dhe drejtësinë penale për të mitur | | • Publikimi i spotit sensibilizues në media dhe rrjete sociale.<br>• Shpërndarja më e shpejtë e informacionit në target grupet e synuara. | SHPRZHPS | Janar-Dhjetor 2023 |
| **21.** | Vizitë studimore në vendet e rajonit, ku funksionojnë institucione të ngjashme me QPKMR | Shkëmbimi i praktikave dhe eksperiencave të punës | • Njohja me modele të reja programesh rehabilitimi, mënyra sesi zbatohen, njohja me planet më efikase, etj. | SHPRZHPS Institucione/OJF të huaja | Janar-Dhjetor 2023 |

**Propozoi:**
**Përgjegjës i Komanduar, Sektori I Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Zhvillimit të Programeve të Specializimi**

**Anda Hysi**

**Miratoi:**

**Drejtor**

**Klaudia Hasanllari**